



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHITIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Gusht 2022

8

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHITIT PËR RININË DHE FËMIJËT



AGJENCIA
KOMBËTARE
E RINISË

Thirrja II

për Projekt - propozime

synon të adresojë prioritetet
e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029

- Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të të rinjtë.
- Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës.
- Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore të të rinjve.



RINIA PËR
RININË

* Thirrja do të qëndrojë
e hapur nga data 22 gusht
deri më 20 shtator 2022.
www.rinia.gov.al

HAPET THIRRJA E II PËR PROJEKT-PROPOZIME RINORE, PËR TË MBËSHKETUR ORGANIZATAT RINORE/ PËR TË RINJTË DHE BASHKITË E VENDIT.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë, hap **Thirrjen e II për Projekt-propozime**, për të mbështetur organizatat rinore/ për të rinjtë dhe bashkitë e vendit. Gjithashtu synon të adresojë prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, sipas fushave të përparësisë: **Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të të rinjtë; Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës; Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore të të rinjve.** Dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore synon rikonstruksionin, ndërtimin, rindërtimin dhe funksionin e objekteve publike, pjesë e infrastrukturës rinore si: qendra rinore, biblioteka dhe qendra rekreative për të rinjtë.

Si risi, këtë vit është **dyfishuar granti për rininë** dhe siguruar **efektivitet të lartë dhe transparencë** në menaxhimin e thirrjeve për projekt-propozimet rinore, nëpërmjet **zbatimit të metodologjisë LOD**, si një nga praktikatat më të suksesshme të BE-së në vend dhe rajon. Përkatësisht, projekt-propozimet fituese nga **organizatat rinore do mund të mbështeten deri në 1.5 milionë lekë** dhe ato nga **organizatat për të rinjtë do të mbështeten me 3.5 milionë lekë**. Ndërsa, për projekt-propozimet e ardhura nga **bashkitë e vendit është siguruar një fond prej 10 milionë lekësh**. Thirrja do të qëndrojë e hapur nga **data 22 gusht deri më 20 shtator!**

Për më shumë informacion www.rinia.gov.al

STRATEGJIA KOMBËTARE E RINISË 2022-2029 TASHMË NË KONSULTIM PUBLIK!

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 ka kaluar në fazën e konsultimit publik, për të cilin Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka hapur këtë muaj **thirrjen për konsultim dhe mbledhje të komenteve e sugjerimeve** në adresën elektronike www.konsultimipublik.gov.al.

Ky proces do të qëndrojë i hapur **deri më datë 8 shtator 2022**. Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 do të krijojë më tepër mundësi të reja dhe **do të promovojë akoma më shumë potencialin rinor shqiptar**, duke i dhënë jehonë të jashtëzakonshme fuqizimit të të rinjve dhe angazhimit të tyre në vendimmarrje.

Ndërlidhja e **Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 me Programin e Qeverisë 2021-2025** u prezantua dhe në **procesin e konsultimit për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritimit 2030**. Si dhe pikëprerja e tyre me **procesin e integritimit evropian**, lidhur me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm sipas përcaktimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe marrëveshjeve të ndryshme me Bashkimin Evropian.



MBLIDHET KËSHILLI KOMBËTAR I RINISË PËR MBARËVAJTJEN E PROCESIT TË THIRRJES SË II PËR PROJEKT-PROPOZIME

Më 4 gusht u mbledh **Këshilli Kombëtar i Rinisë me qëllim konsultimin rreth programit vjetor të financimit** dhe prioritetëve ku do fokusohet Thirrja e II për Projekt-propozime rinore të Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Këtë vit është dyfishuar granti për rininë dhe siguruar efektivitetin e lartë dhe transparencën në menaxhimin e thirrjeve për projekt-propozimet rinore, nëpërmjet zbatimit të metodologjisë LOD.

Gjatë takimit u diskutua **rëndësia e kontributit të vazhdueshëm këshillues të KKR-së** sa i përket **realizimit të proceseve kyçe në fushën e rinisë** të tilla si, **ngritja e KVR-ve apo ligji "Për Rininë"**, që prekin drejtpërdrejt të rinjtë në Shqipëri. **Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor** që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë dhe propozon politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë, si dhe drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KRYEMINISTRIA
MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Gusht 2022

8

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË RINISË, MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT ORGANIZOI KAMPIN "RINIA VENDOS" ME MBI 100 ANËTARË TË KVR-VE

Me qëllimin kryesor për të krijuar **ura të reja bashkëpunimi mes të rinjve të Këshillave Vendor Rinor (KVR), Këshillit Kombëtar Rinor (KKR) dhe qeverisjes qendrore**, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me mbështetjen e UNDP-së, bëri bashkë më shumë se **100 anëtarë të KVR-ve nga 26 strukturat bashkiake, në kampin veror "Rinia Vendos"**. Ky organizim u mbajt në kuadër të **Ditës Ndërkombëtare të Rinisë**, përgjatë datave **12-13-14 gusht**, në Divjakë.

Pjesë e kampit ishin dhe **personalitete të mirënjohura në fushën e aktivizimit dhe politikës**, të tillë si nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Arban Mazniku, dhe deputeti i Parlamentit, Etjen Xhafaj, të cilët ndanë me të rinjtë përvojën dhe rrugëtimin e tyre që nga aktivizimi e deri te përfshirja në proceset vendimmarrëse politike. Gjithashtu, të rinjtë patën mundësinë të **shkëmbejnë ide e sugjerime me njëri-tjetrin** dhe të përcaktojnë **hapat konkrete që do të ndjekin për të përmirësuar komunitetin** ku ata jetojnë.

Nuk munguan as aktivitetet argëtuese si **bisedat e hapura dhe të sigerta rreth zjarrit** mes Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe anëtarëve të KVR-ve **të cilët ndanë mendimet, eksperiencat dhe qëllimet e tyre afatgjatë**. Si dhe u zhvilluan plot **aktivitete sportive** ku të rinjtë u argëtuan me plot lojëra e sfida të ndryshme.

MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT MIRËPRET NË SHQIPËRI KAMPIONEN E EVROPËS NË ATLETIKË, LUIZA GEGA

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, më 22 gusht, mirëpriti kampionen e Evropës në garën e 3000 metrave me pengesa, Luiza Gega, nga ku solli në vëmendje Programin Kombëtar të Ekipeve Sportive që po zhvillohet në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar. Gjithashtu u mbajt dhe ceremonia e nderimit të atletes kampione të Evropës, së cilës iu dorëzua Kordoni i madh me Yllin për Mirënjohje Publike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KRYEMINISTRIA
MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi